- Reina Barranco Francisco Euro 4.800,00 (katërmijë e tetëqind presje zero zero);

- Tripodi Antonio Euro 2.400,00 (dymijë e katërqind presje zero zero)

Kuota e pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin themeltar janë të përcaktuar në përpjesëtim me kontributet e lartpërmendura, dhe për këtë arsye kapitali themeltar është i ndarë si më poshtë:

- Mazzia Edoardo 40% (dyzetë përqind) me vlerë të përgjithshme 4.800,00 (katërmijë e tetëqind presje zero zero)
- Reina Barranco Francisco 40% (dyzetë përqind) me vlerë të përgjithshme 4.800,00 (katërmijë e tetëqind presje zero zero)
- Tripodi Antonio 20% (njëzetë përqind) me vlerë të përgjithshme 2.400,00 (dymijë e katërqind presje zero zero).

Neni 6

Anëtarët e paraqitur zgjedhin formën e administrimit me Këshill Adimistrimi të përbërë nga tre anëtarë të cilët janë në detyrë deri në momentin e revokimit ose me dorëheqje.

Emërohen anëtarët e parë të Këshilit të Admistrimit zotërinjtë:

- Mazzia Edoardo (President)
- Reina Barranco Francisco (Këshilltar)
- Tripodi Antonio (Këshilltar)

të cilat, siç janë përshkruar më lart, deklarojnë se e pranojnë detyrën siç u është dhënë më sipër dhe se nuk ka shkaqe të papranueshmërisë ose revokimit të parashikuara me ligj.

Neni 7

Në zbatim të dispozitave të paragrafit të katërt të artit. 2464 K.C ortakët paguajnë në organin administrativ siç është caktuar më lart, i cili lëshon një faturë, 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të shoqërisë të përshkruar si më lartë, të barabartë në total me Euro 3.000,00 (tre mijë presje zero zero) në mënyrën vijuese:

- Z. Mazzia Edoardo derdh shumën prej Euro 1.200,00 (njëmijë e dyqind presje zero zero) korisponent me 25% të pjesëmarrjes të nënshkruar prej tij, në shumën prej Euro 4.800,00 (katërmijë e tetëqind presje zero zero) me anë të një cek banke të Monte dei Paschi di Siena lëshuar më 9 Shkurt 2017, me të njëjtën shumë, jo të transferueshme, n 6076335253;
- Z. Barranco Francisco Reina derdh shumën prej Euro 1.200,00 (njëmijë e dyqind presje zero zero) korisponent me 25% të pjesëmarrjes të nënshkruar prej tij, në shumën prej Euro 4.800,00 (katërmijë e tetëqind presje zero zero) me anë të një cek banke të Monte dei Paschi di Siena lëshuar më datën e sotme, me të njëjtën shumë, jo të transferueshme, n. 6076335257
- Z. Tripodi Antonio derdh shumën prej Euro 600,00 (gjashtëqind presje zero zero) korisponent me 25% të pjesëmarrjes të nënshkruar prej tij, në shumën prej 2.400,00 (dymijë e katërqind presje zero zero) me anë të një cek banke të Unicredit lëshuar më datën 9 shkurt 2017, me të njëjtën shumë, jo të transferueshme, n 7400953692.

Neni 8

Palët e paraqitura deklarojnë se shpenzimet e themelimit në ngarkim të shoqërisë janë përafërsisht në shumën prej Euro 3.000,00 (tremijë presej zero zero)

STATUTI

I SHOQËRISË "FRED ENGINEERING" SH.P.K

Neni 1 – Emërtimi



Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin:

"FRED ENGINEERING" SH.P.K

Neni 2 – Selia

Shoqëria ka selinë në Romë në adresën e përcaktuar nga Ogarni Administrativ, i cil do të hapë dhe do të mbyllë seli dytësore, filiale, dege të shoqërisë, zyra, asgjensi, përfaqësime, depozita dhe njësi vendore në të njëjtën komunë ose diku tjetër, si në Itali dhe jashtë saj.

Neni 30 – Objekti i Shoqërisë

Shoqëria ka si objekt, si në Itali dhe jashtë vendit, kryerjen e aktiviteteve të mëposhtëme

-Shërbime inxhinierike:

Ofrimi i shërbimeve me një përmbajtje të lartë teknike dhe profesionale, siç janë studimet, hulumtimet, analizat dhe matjet, konsulenca, organizimi dhe menaxhimi i kurseve profesionale, projektimi, menaxhimi operacional, drejtimi i punimeve, koordinimi i sigurisë në projektion dhe në ekzekutim që lidhen me sektorët e arkitekturës, të inxhinierisë civile dhe industriale, të mjedisit, të territorit, të infrastrukturave, të energjisë, të informacionit, të domotikës, të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe marketing analitik në lidhje me to, strategjik dhe operativ. Studime të fizibilitetit, hulumtim, konsulencë, vlerësime të përshtatshmërisë tekniko-ekonomike, studime të ndikimit në mjedis dhe pajtueshmëri mjedisore, vlerësime të ndikimit në mjedis, operacione rregullim dhe mbrojtje të territorit. Vëzhgime dhe hulumtime gjeologjike, gjeoteknike, hidrogeologjike, anketime topografike, ajrore fotogrametrike dhe të çfarëdo lloji me përdorimin e çdo mjeti të disponueshëm në treg në kohën e caktimit të detyrës. Kryerja e veprimtarive monitoruese të çfarëdo lloji dukurie të zhvilluara edhe me kryerjen e sondazheve, hetimeve, analizave, marrjes së mostrave, inspektimeve, kërkimeve, vlerësimeve dhe karakterizimeve mjedisore, kimike, fizike ose të tjera, në fushën civile dhe industriale, publike dhe private.

-Shërbime për profesionistët

Ofrimi i shërbimeve dhe instrumenteve për profesionistët dhe studiove teknike më lidhje me: përpunimi i të dhënave, përpunimi grafik, shërbimet telematike, matjet e të çdo lloji madhësi fizike. Dhënia me qira e hapësirave të pajisura dhe marrja me qira e makinave, makinerive, pajisjeve, instrumenteve të matjes dhe analizës, për profesionistët dhe studiot teknike në përgjithësi.

-Mbështetje për administratat publike dhe private

konsulencë për prokurimin e punëve publike dhe ekzekutimin e punimeve. Mbështetje për Administratat publike dhe private në fushën e Sigurisë dhe Higjenës në punë. Mbështetje për Administratat Publike në lidhje me verifikimin e projekteve për qëllime Vlefshmërie. Menaxhimi i kontratave dhe kontrolli i specifikimeve të kontratës për furnizimet e punëve me interes civil dhe industrial, privat ose publik.

-Sistemet e menaxhimit të integruar

konsulencë dhe asistencë për organet publike që synojnë marrjen e certifikatave të Cilësisë, Sigurisë, të Mjedisit dhe përgjegjësisë Sociale të Shoqërisë dhe të ngjashme.

-Project Finance, Kontraktuesit të Përgjithshëm (General Contractor) dhe sistemeve "celsa në dorë";

Aktivitetin e Promovimit dhe/ose të shoqërive të projektimit në iniciativat e Project Finance në sektorin publik dhe privat. Kryerja e veprimtarive dhe funksioneve të Kontraktuesit të Përgjithshëm (General Contractor). Vendosja e marrëdhënieve të agjencisë dhe tregtimi i pajisjeve dhe sistemeve të përparuara të teknologjisë, instrumentizimi, impiante, në formën "celsa në dorë" në sektorët civilë dhe industrialë dhe menaxhimin e territorit.

- Menaxhimi i pasurive të paluajtshme

Kryerja e veprimtarive të administrimit të pasurive të patundshme, përfshirë blerjen, shitjen, marrjen me qira, madje edhe financiare të pronave të çdo lloji dhe në veçanti të ndërtesave dhe komplekseve të pasurive të patundshme bujqësore, urbane dhe industriale, si dhe kryerjen e aktiviteteve të rimëkëmbjes, zhvillimit, integrimin në territor dhe transferimin e çdo lloji pasurie të paluajtshme.

-Zhvillimi teknologjik

çfarë është e nevojshme për zhvillimin teknologjik të industrive mekanike, kimike, petrokimike, biokimike, farmaceutike, dhe të energjisë bërthamore, termoelektrike dhe të rinovueshme, të industrive të energjisë zëvendësuese, të industrive minerare, transformuese dhe prodhuese të qymyrit, hekurit, çelikut, metaleve dhe minerale jo metalike, të industrisë elektrike dhe elektronike, të industrisë ushqimore, bujqësore, blegtorale, peshkut dhe informacioni. Inxhinierizimi i proceseve industriale me furnizim të pajisjeve kompjuterike dhe software. Organizimi dhe administrimi, në emër të tij dhe në emër të palëve të treta, me ofrimin e ndihmës, konsulencës, shërbimeve teknike-tregtare, proceset industriale, punimet dhe instalimet e çdo lloji dhe destinacioni në sektorin industrial, transportin tokësor, detar dhe ajror, të ndërtimit, tregtisë dhe infrastrukturës civile, sanitare, rrugore, hekurudhore dhe aeroportit. Zhvillimi i proceseve industriale të shndërrimit në përgjithësi dhe të mbeturinave, përfshirë dhe zhvillimin aktivitetëve të nevojshme të projektimit, ndërtimit, riparimit, transformimit, përmirësimit, zgjerimit, fillimit, testimit, kolaudimit dhe menaxhimit që kanë lidhje me to.

-Furnizimi me makineri

furnizimi i makinerive dhe shërbimeve për kontrollin e punës, mirëmbajtjen, sigurinë në punë, optimizimin e konsumit të energjisë, kontrollin e cilësisë në aktivitetet civile, ose të gjitha ato aktivitete plotësuese që ndihmojnë veprimtaritë e sektorit parësor dhe industriale. Furnizimi i pajisjeve informatike hardware dhe software programeve dhe metodave të monitorimit të territorit, përfshirë infrastrukturën e transportit. Shërbimet profesionale do të kryhen dhe nënshkruhen nga profesionistë të regjistruar rregullisht në organe profesionale, secila brenda kompetencave përkatëse të përcaktuara me ligjet në fuqi. Për kryerjen e shërbimeve ndaj palëve të treta, shoqëria mund të përfitojë nga shërbimet e partnerëve, profesionistëve ose ekspertëve të tjerë të jashtëm, megjithatë të njohura dhe të pranura nga klienti, gjithmonë në përputhje me ligjin në këtë drejtim. Shoqëria mund të marrë pjesë në financime të parashikuara nga ligjet komunitare, kombëtare dhe rajonale në fuqi. Të gjitha aktivitetet e lartpërmendura duhet të kryhen brenda kufijve të rregullave që rregullojnë ushtrimin, si dhe në përputhje me legjislacionin për në lidhje me veprimtaritë e rezervuara për anëtarët e Kolegjeve, Urdhërave ose Shoqatave profesionale, duke marrë formën e kompanisë si një "kompani inxhinierike" në zbatim të ligjit 11 shkurt 1994 n. 109, i Dekretit Legjislativ 12 Prill 2006 n. 163 dhe çdo dispozitë tjetër e cila do të rregullojë çështjen. Për arritjen e objektit shoqëror, në rrugën instrumentale dhe jo parësore, dhe pa konfiguruar asnjëherë ushtrimin e aktivitetit në lidhje të publikut, shoqëria mund: të përmbushë çdo operacion tregëtar, industrial; pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të dobishme dhe të nevojshme; të marrë dhe të japë agjensi, komisione, përfaqësime dhe mandate, të marrë pjesë në kuotat e shoqërive tjera që kanë qëllime të njëjta apo ose te ngjashme, lejojnë regjistrimet e hipotekave.

Neni 4 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar deri më datë 31 dhjetor 2050.

Me vendim të Asamblesë së ortakëve kohëzgjatja mund të jetë më e shkurtër apo mund të shtyhet, pra mund të parashikohet shpërbërja e parakohshme e shoqërisë.

Neni 5 – Kapitai Themeltar

P

Kapitali Themeltar është në shumën prej EURO 12.000,00 (dymbëdhjetë mijë presje zero zero) e ndarë në kuota prej një Euro ose të shumëfishta me një Euro.

Neni 6 –Operacinet e kapitalin themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet me vendim të Asamblesë së ortakëve nëpërmjet kontributeve të reja me anë të kontributeve të reja ose duke shtuar të kapital rezervat dhe fondet e tjera të regjistruara të disponueshme në bilanc. Në rast të rritjes së kapitalit përmes kontributeve të reja, ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë në përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes që ata zotërojnë. Në rast se disa nga ortakët nuk pajtohen, i takon ortakëve të tjerë të pajtohen me rritjen e kapitalit të pa papranuar nga ortakët e tjerë, gjithmonë në përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes që ata zotërojnë. Përvec rastit të parashikuar nga neni 2482 i K.c, rritja e kapitalit mund të kryhet dhe nëpërmjet ofertave për kuota të reja nga palët e treta; në këtë rast ortakëve që nuk kanë pranuar këtë vendim i takon e drejta e tërheqjes sipas nenit 2473 të k.c

Neni 7- Kontributet

Kontributet jepen sipas asaj që përcaktohet nga ligji. Për kontributet zbatohet dispozitat e k.c nga neni 2464 deri në nenin 2466.

Neni 8- Kuotat e pjesëmarrjes. Të drejtat e ortakëve të veçantë

Kuotat e pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin themeltar përcaktohen në përpjesëtim me kontributet dhe marrin të drejta proporcionale në shoqëri. Me vendimin unanim të Asmablesë së Ortakëve, mund të përcaktohen kuotat e pjesëmarrjes që nuk janë proporcionale me kontributet dhe mund të përcaktohen dhe të drejtat e veçanta drejt ortakëve të veçantë në lidhje me administrimin e shoqërisë ose shpërndarjen e fitimeve.

Neni 9 - Financimi i ortakëve

Shumat e derdhura për shoqërinë nga ortakët konsiderohet se janë dhënë si një financim nëse nga bilancet e aprovuara nuk tregojnë se pagesa është bërë për një arsye tjetër. Financimet me të drejtën e kthimit të shumës së paguar mund të bëhen në favor të Shoqërisë nga ortakët, edhe nëse jo në proporcion të pjesëmarrjes përkatëse, me modalitetet dhe kufijtë e përmendur me ligj herë pas here në lidhje me mbledhjen e kursimeve; Këto financime janë pa interes, nuk mund të sjellin forma të tjera të kompensimit, përveç rastit nëse vendoset ndryshe nga Asambleja e Ortakëve, vendim i cili merret gjithmonë në përputhje me rregulloret në fuqi për temën e mbledhjes së kursimeve. Kërkesat për financim nga ortakët, të vendosura nga çdo organ i shoqërisë, kurrë nuk mund të marrin vlerën e detyrueshme kundrejt vetë ortakëve. Për rimbursimin e financimeve të ortakëve aplikohet neni 2467 i k.c.

Neni 10- Blerja e pasurive nga ortakët

Sipas prashikimit të nenit 2465 pika e dytë e kodit civil, blerja nga ana e Shoqërisë, për një tarifë të barabartë ose më të madhe se një e dhjeta e kapitalit themeltar, të pasurive apo kredive të ortakëve dhe administratorët në dy vitet nga regjistrimi i kompanisë në Regjistrin e Biznesit, nuk duhet të autorizohet me vendim ortakësh.

Neni 11 – Libri i ortakëve. Banimi i ortakëve

Pranë shoqërisë mbahet, nën kujdesin e organit administrativ, një libër anëtarësh në të cilin duhet të shënohen gjeneralitetet e plota dhe vendbanimi i secilit anëtar, kuotat e pjesëmarrjes për secilin prej tyre me indeksin e derdhjeve relative, si dhe çdo ndryshim që ndodh në të dhënat e mësipërme. Legjitimiteti për të ushtruar të drejtat në shoqëri i nënshtrohet regjistrimit në librin e ortakëve, që do të kryhet nga organi administrativ, pa vonesë, pas paraqitjes së dokumenteve mbështetës të nevojshëm. Në mungesë të këtij regjistrimi, përvetësimi i cilësisë së anëtarit, për çfarëdo arsye, nuk

do të ketë efekt në shoqëri. Në asnjë rast nuk mund të kenë vlerë kundrejt shoqërisë, megjithëse janë depozituar pranë regjistrimit të shoqërive, aktet që transferojnë pjesëmarrjet në shoqëri të cilat janë hartuar në kundërshtim me limitet e përcaktuara nga ky statut për transferimin e lirë të vetë pjesëmarrjeve. Në këtë rast, organi administrativ është i detyruar të refuzojë regjistrimin e transferimit në librin e ortakëve dhe, nëse kërkohet, të transmetojë raportet e duhura të rrethanave tek autoritetet kompetente. Vendbanimi i ortakëve, për sa i përket marrëdhënieve të tyre me shoqërinë, sipas ligjit rezulton ai që është shënuar në librin e ortakëve.

Neni 12 - Trasferimi i kuotave. Trasferimi në raste vdekje.

Kuotat e pjesëmarrjes janë të transferueshme me akt midis të gjallëve me respektimin e dispozitave të mëposhtme.

Ortaku që ka ndërmend të tjetërsojë pjesëmarrjen e tij ose një pjesë të tij, është i detyruar, duke specifikuar çmimin, blerësin dhe procedurën e transferimit, ta ofrojë atë me shkrim, me letër rekomande me vërtetimin e marrjes, me të drejtën e parablerjes nga ortakët e tjerë, të cilën duhet të ushtrjnë këtë të drejtë me shkrim ndaj propozuesit, me anë të letrës rekomande me kthim përgjigje brenda një muaji nga oferta. E drejta e parablerjes nuk mund të ushtrohet mbi të gjithë kuotën e ofertës nga çdo ortak, por në proporcion me pjesëmarrjet aktuale. E drejta e parablerejs mund të ushtrohet në të gjithë kuotën nga secili anëtar i ortak për shitje, duke mos lejuar para-marrje të pjesshme. Nëse disa ortakë, individualisht dhe bashkërisht, synojnë të bëhen blerës të së njëjtës kuotë të ofruar për shitje, secili do të bëjë blerjen në përpjesëtim me pjesëmarrjen tashmë në pronësi të tij. Nëse askush nuk e ushtron të drejtën e parablerjes, ortakët do të jetë në gjendje të transferojë blerësit e treguar, në kushtet e sjella nga propozimi, tarifën e pjesëmarrjes të ofruar për shitje. Në rast se çmimi i kërkuar vlerësohet i tepërt nga një ose më shumë aksionarë, këta të fundit dhe ortakët ofrues do të bien dakord për emërimin e një arbitri të thirrur për të vendosur çmimin e shitjes me kritere të drejta dhe objektive, duke marrë parasysh pozicionin financiar dhe të ardhurat e shoqërisë. Në rast të mos arritjes së marrëveshjes për emërimin e arbitrit, ky i fundit do të oërcaktohet nga Kryetari i Gjykatës së vendit ku shoqëria ka selinë e saj të regjistruar me kërkesë të palës më të kujdesshme. Parablerja nuk zbatohet në rastin e transferimit në favor të të afërmeve në një vijë të drejtë të partnerit transferues; gjithashtu nuk zbatohet në rastin e transferimit në një kompani besimi të autorizuar për të kryer një veprimtari të tillë, si dhe ritransferimin nga e njëjta për të ortakun të besuari fillestar, me paraqitjen paraprake të mandatit të besimit. Transferimi që kryhet në kundërshtim me dispozitat e mësipërme konsiderohet i paefektshëm në lidhje me shoqërinë dhe pasardhësi në titull nuk mund të ushtrojë asnjë veprim të lidhur me pronësinë e aksioneve të fituara. Kuotat e pjesëmarrjes janë lirisht të transferueshme për shkak të vdekjes. Në rast të hyrjes së më shumë se një trashëgimtari, pjesa e ortakut të ndjerë kuptohet se shpërndahet automatikisht mes tyre, sipas të drejtave që u përkasin atyre.

Neni 13 – Tërheqja e ortakëve

Secili ortak kur lejohet me ligj apo në këtë Statut, mund të ushtrojë të drejtën e tërheqjes sipas nenit 2473 të k.c. duke i dhënë komunikim organit Administrativ, pranë adresës së selisë qendrore të shoqërisë, nëpërmjet një ketër rekomande me kthim përgjigje e cila do të dërgohet brenda një muaji nga shkaku i cili i jep të drejtën e tërheqjes, pra brenda afatit të ndryshëm dhe me njoftimin e përcaktuar me ligj. Dita tërheqja do të kuptohet në ditën kur letra rekomande arrin destinacionin e saj.

Neni 14 – Asambleja e Ortakëve

Vendimet e ortakëve meren gjithmonë nëpërmjet vendimit të asamblesë të mbledhur sipas nenit 2479 të K.c dhe sic parashikohet në këtë Statut. Janë megjithatë në kompetencë të Asamblesë së ortakëve vendimet detyrues të rezervuara për ortakët e shoqërisë sipas ligjit apo siç përcaktohet në statut.

Neni 15 – Thirrja dhe themlimi i Asamblese së Ortakëve

N

Asambleja e Përgjithshme mbledhet zakonisht në adresën e selisë qendrore të Shoqërisë ose në raste të veçanta edhe në adresë tjetër për sa kohë që është në Itali dhe thirret me letër rekomande, gjithashtu dorëzuar me dorë, dërguar ortakëve të paktën tetë ditë para mbledhjes në adresat që rezultojnë nga libri i ortakëve. Letra duhet të tregojë ditën, vendin dhe kohën e mbledhjes dhe rendin e ditës që do të trajtohet.

Edhe në mungesë të thirrjes zyrtare për mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, vendimi në çdo rast quhet i miratuar kur të marrë pjesë i gjithë kapitali themeltar, kur të gjithë Administratorët dhe auditorët ligjorë, nëse emërohen, janë të pranishëm në mbledhje ose të informuar për të dhe askush nuk kundërshton diskutimin e argumentit siç parashikohet nga pika e fundit e nenit 2479 bis të Kodit Civil. Për qëllimet e lartpërmendura, administratorët në mungesë dhe organit të kontrollit u kërkohet të dërgojnë një deklaratë me shkrim në selinë qendrore të Shoqërisë deri në datën e caktuar për mbledhjen, për t'u mbajtur në regjistrat e kompanisë, duke treguar që ato ishin të informuar për takimin dhe temat që do të diskutohen.

Asambleja duhet të mbledhet të paktën një herë në vit brenda njëqind e njëzet ditëve nga përfundimi i vitit ushtrimor, përvec mundësisë për një afat më të gjatë që tejkalon njëqind e tetëdhjetë ditë, brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit. 2364 k.c.

Cdo ortak mund të përfaqësohet në mbledhje nga një person tjetër, madje edhe një jo-ortak, me një mandat ose një autorizim të thjeshtë me shkrim. Përfaqësimi nuk mund t'i besohet Administratorëve dhe Organit të kontrollit ose Audituesit nëse emërohen.

Asambleja kryhesot, ne varësi të tipit të Organit Administrativ Unik, nga një prej Administratorëve ose nga Presidenti i Këshillit të Adminstrimit dhe në mungesë të tyre nga persona të tjerë të emëruar nga ata.

I takon Presidentit të Asmblesë të vlerësojë rregullsinë e mandatave të cilat do të ruhen pranë shoqërisë.

Neni 16 - E drejta e votës

Secili ortak i regjistruar në librin e ortakëve i cili nuk është levizur në lidhje me shoqërinë sipas nenit 2466 të k.c. ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble dhe vota e tij vlen në masë proporcionale me pjesëmarrjen e tij.

Neni 17 – Vendimet

Asambleja vendos në mënyrë të vlefshme sipas nenit 2479 të k.c, përveç shumicave të ndryshme të përcaktuar në këtë Statut ose të rregullave të paraktuara me ligj.

Vendimet e Asamblesë duhet të rezultojnë në verbal të nënshkruar nga Presidenti dhe nga Sekretari, nëse emërohet.

Verbali i asamblesë hartohet nga një noter në të gjitha rastet kur e kërkon ligji ose ky Statut.

Verbali i Asamblesë, edhe nëse hartohet si akt publik, duhet të regjistrohet pa vonesë në Librin e vendimeve të ortakëve.

Neni 18 – Administrimi

Me vendim të Asamblesë së ortakëve administrimi i shoqërisë i besohet në mënyrë alternative, një:

- administratori të vetëm
- më shumë Administratorë që mund të operojnë, sipas vendimit të Asamblesë në aktin e emërimit, të cilët mund të operojnë veçmas njëri – tjetrit sipas parashikimit të nenit 2257 të k.c., ose bashkërisht sipas nenit 2258 k.c.
- një Këshill Adminstrimi që përbëhet nga dy deri në pesë anëtarë sipas numrit të përcaktuar nga ortakët në aktin e emërimit.

Administratorët mund të jenë dhe jo ortakë, kanë kohëzgjatje në detyrë deri në revokimin e emërimit ose dorëheqje gjatë periudhës të përcaktuar nga ortakët në aktin e emërimit, dhe mund

të rizgjidhen. Në rastin e Këshillit të Administrimit, një nga anëtarët emërohet President; nëse nuk e ka përcaktuar Asambleja e ortakëve, emërimi do të kryhet vetë Këshilli, i cili gjithashtu mund të emerojë një Zv. President dhe/ose një ose më shumë Administratorë të Deleguar ose të delegojë një ose më shumë prej anëtarëve të vet të kryejë detyrën e Presidentit, në rast të mungesës së tij ose të pamundësisë së tij.

Përfundimi i mandati të administratorit në afatin e përcaktuar ka efekt nga momneti në të cilin Organi Administrativ është rithemeluar.

Neni 19 – Kompetencat dhe përfaqësimi

Përveç reervave që parashikohen në ligj apo në këtë Statut për kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Ortakëve, Administratori i vetëm, administratorët veçmas ose bashkërisht, ose Këshilli i Administrimit mund të kryejë, me kompetencat më të gjera, të gjitha aktet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të menaxhimit të Shoqërisë që ata konsiderojnë të dobishme për arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë përfshirë ato të emërimit të avokatëve për vepra të vetme ose kategori veprash, fiksimit e kohëzgjatjes dhe modaliteteve të tyre, dhe pohimin e anulimit të hipotekave

Administratorit të Vetëm, Administratorët veçmas ose bashkërisht, ose Presidentit të Këshillit të Administrimit dhe, nëse emërohen, Zv Presidentit dhe Administratorëve të deleguar, veçmas njëri-tjetrit, i takon i takon fimra dhe përfaqësimi i Shoqërisë kundër të tretëve dhe në gjykim.

Organit administrativ i jepet e drejta për të krijuar bashkim me përfshirjen e një kompanie tërësisht ose me 90% sipas nenit 2505 pika e dytë dhe nenit 2505 pika e dytë e k.c.

Neni 20- Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

Këshilli i Administrimit thirret nga Presidenti, në rast të mungesës ose pengesës së tij nga kushdo tjetër që zë vendin e tij, sa herë që e gjykon të domosdoshme ose kur të paktën një e treta e këshilltarëve e kërkojnë atë, me një njoftim që të dërgohet me letër rekomande qoftë edhe me dorë, të paktën tetë ditë para mbledhjes që përmban një tregues përmbledhës të temave që do të diskutohen. Në raste urgjente, njoftimi mund të dërgohet me telegram ose faks ose një mënyrë tjetër të komunikimit të shkruar të përshtatshëm për qëllimin, të paktën dy ditë para ditës së caktuar për mbledhjen.

Në mungesë të njoftimit, Këshilli do të përbëhet në mënyrë të ligjshme me praninë e të gjithë anëtarëve të tij.

Sekretari mund të zgjidhet nga të huajt dhe të nënshkruajë procesverbalin e mbledhjeve së bashku me Presidentin.

Takimet do të jenë të vlefshme nëse është prezente shumica e anëtarëve.

Vendimet e tij do të jenë të vlefshme me shumicë votash; vota e Presidentit do të ketë vlerë të dyfishtë në rast barazim votash.

Neni 21 – Kompensimi

Organi administrativ për punën dhe përgjegjësinë e tij mund ti njihet, nga viti në vit, një shpërblim fiks dhe / ose në përqindje të fitimeve të arritura, të cilat mund të përcaktohen në miratimin e raportit nga ana e Asamblesë së ortakëve. Përveç shpërblimit aktual, mund të përcaktohet kompensimi i mandatit; prandaj do të jetë përgjegjësia e Asamblesë së Ortakëve të krijojë një provizion vjetor në ngarkim të Shoqërisë.

Sidoqoftë, Organi Administrativ ë i përket rimbursimi i shpenzimeve të bëra për shkak të detyrës

Neni 22 – Kontrolllet e ortakëve

Ortakët që nuk marrin pjesë në administrimin kanë të drejtë të kenë nga organi Administrativ njoftime mbi zhvillimin e punëve të shoqërisë dhe të konsultohen, dhe nëpërmjet profesionistëve të tyre të besuar, me librat e shoqërisë dhe dokumentat që kanë lidhje me administrimin.

Secili ortak mund të promovojë veprimin e përgjegjësisë ndaj administratorëve.

Neni 23 - Bilanci

Viti ushtrimor mbyllet në datë 31 dhjetor të çdo viti. Në mbyllje të çdo viti ushtrimor Administrativ harton bilancin e vitit ushtrimor në përputhje me dispozitat e ligjit.

Bilanci i secilit vit bashkë me dokumente e tjera të kërkuar nga ligji duhet, me depozitim paraprak në selinë qendrore në mënyrat dhe termat e parshikuara nga ligji, të nënshtrohen aporvimit të Asamblesë së ortakëve brenda njëqind e njëzet ditësh pas mbylljes të vitit ushtrimor, përveç mundësisë të një afati më të gjatë, jo më të madh se njëqind e tetëdhjetë ditë, sipas limitve dhe kushteve të përcaktuara në pikën e dytë të nenit 2364 të k.c.

Neni 24 – Shpërndarja e fitimeve

Pa cënuar dispozitat e ligjit në lidhje me destinacionin e një pjese të fitimeve neto në rezervën ligjore, vetë fitimet do ndahen nga viti në vit, sipas vendimeve të Asamblesë së ortakëve, pa paragjykuar ndonjë të drejtë të veçantë që i atribuohet aksionarëve individual, në zbatim të ligjit dhe të këtij Statuti në lidhje me shpërndarjen e fitimeve

Neni 25 - Kontrolli ligjor i llogarive

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë, duke përcaktuar kompetencat dhe fuqitë e tij, përfshirë auditimin ligjor të llogarive, një organ kontrolli që mund të jetë monokratik ose kolegjal, ose një auditues.

Në rastin e organit kolegjal, ky do të jetë i përbërë nga tre anëtarë efektiv dhe dy zëvendësues.

Emërimi i orgait të kontrollit ose e audituesit është i detyrueshëm sipas rasteve të parashikuara në nenin 2477 të k.c.

Organit të kontrollit i aplikohet disiplina e parashkuar për vepime në lidhje me Kolegjin Sindakal.

Neni 26 – Likuidimi

Nëse do të verifikohet një nga shkaqet e shpërndarjes të parashkuar sipas nenit 2484 të k.c shoqëria do të vihet në likuidim dhe Asembleja e ortakëve do të emërojë një apo më shumë Likuidatorë të cilët do të operojnë më të gjitha fuqitë e parashikuara nga ligji. Për shpërndarjen dhe likuidimin e shoqërisë alikohen dispozita e neni 2484 deri në 2496 të k.c.

Neni 27- Klauzola e arbitrazhit

Çdo mosmarrëveshje që lind midis ortakëve ose midis ortakëve dhe shoqërisë me objekt të drejtat e disponueshme në lidhje me marrëdhëniet në shoqëri, duke përjashtuar ato që me ligj nuk mund të komprometohen në arbitrazh, do t'i referohen Arbitrit të caktuar nga Kryetari i Gjykatës së Rrethit ku Shoqëria ka selinë e saj qendrore.

Arbitri do të vendosë me paanësi, përveç në rastet kur ligji parashikon që ai vendos sipas ligjit të shoqërive tregtare.

Për procedurën e arbitrazhit zbatohet ligji aktual në fuqi për procedurat në lidhje me ligjin shoqërive tregtare.

Asambleja e ortakëve mund të modifikojë ose të anultojë dispozitat e përmëndura në këtë nen me vendim të marrë me votën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e kapitalit themeltar.

Neni 28 – Legjislacioni i zbatueshem

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe ligjet e veçanta përkatëse.

Për sa kërkohet më sipër marr këtë vepër që e botoj duke ja lexuar unë Noteri personave të paraqitur të cilët të pyetur nga unë kanë deklaruar vullnetin e tyre të lirë dhe nënshkruajnë në orën pesëmbëdhjetë e pesëmbëdhjetë (ora 15:15).

Është shkruar me makinë shkirmi nga dy persona të besuar prej meje dhe nën kujdesin tim nga unë Noteri e kompletuar në njëzet e katër faqe dhe viza katër nga kjo e njëzet e gjashta e shtatë faqeve në të cilën përfundon.

Nënshkruar
Edoardo Mazzia
Francisco Reina Barranco
Tripodo Antonio
Pierpaolo Siniscalchi Noter



Kopje njësuar me origjinalin, (depozituar pranë studios time, firmosur sipas ligjit), e përbërë nga trembëdhjetë faqe e cila lëshohet për qëllime tatimore

Në studion time, më 1 mars 2017

Prokura e republikës së Velletri

Apostile

(Konventa e De La Haye e 5 tetorit 1961)

1. Shteti :ITALI

Ky akt publik

2. është firmosur nga Pierpaolo Siniscalchi

3. në cilësinë e: Noterit

4. dhe e pajisur me vulat/pullat e Pierpaolo Siniscalchi Noteri i Velletri-t

Vërtetuar

5. ne Velletri 6. më: 30/09/2019

7. nga Zv. Prokurori i Republikës (Z. Giuseppe TRAVAGLINI)

8. me numër 602/19

9. Vula/Pulla

10. Firma

Zv. Prokurori i Republikës (Z. Giuseppe TRAVAGLINI)

PERKTHEU
LORENA RUSHITI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr.4698.... Rep.

VËRTETIM

Sot, më datën 17.10.2019 (*dy mijë e nëntëmbëdhjetë*), përpara meje, Noter Lorian A. Robo, noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, në zyrën noteriale me seli në Rr. "Ismail Qemali", P. 27/1, Tiranë, u paraqit personalisht Znj. Lorena Rushiti, e njohur prej meje si përkthyesë e gjuhës italiane, e cila deklaroi se dokumentin bashkëngjitur e përktheu në përputhje me origjinalin, nga gjuha Italiane në gjuhën shqipe dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyesit në përputhje me Ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe dispozita të tjera të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

